VENDIM
Nr.335, datë 14.8.1997

PËR PROCESIN PËRGATITOR PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË KUSHTETUTËS

Në kuadrin e masave që duhen marrë, për fillimin e punës për hartimin e projektit të kushtetutës, në mbështetje të nenit 85 e 88 të Rregullores së Kuvendit popullor,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Hartimi i projektit të kushtetutës të paraprihet nga një proces përgatitor me qëllim sensibilizimi të opinionit publik, organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare.
2. Ngarkohet Kryesia e Kuvendit Popullor që në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave të organizojë këtë proces përgatitor duke angazhuar ekspertë vendas dhe të huaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.